



Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. Agim Ramadani Nr.23, Prishtinë-Kosovë, Tel: +381 (0)38 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit (Agjencia), duke u bazuar në nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime), Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/45 si dhe duke u bazuar në Aktvendimin nr. AC-I-16-0268-A0001, të datës 28.08.2017 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me datë **13.09.2017**, shpall këtë:

NJOFTIM LIDHUR ME ANULIMIN E FTESËS PËR APLIKIM ME QËLLIM TË HARTIMIT TË LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PUNËTORËVE PËR NSH "TEUTA BARE" NË MITROVICË DHE NSH KB "ZIVKO VASIC" NË RANILLUG-KAMENICË, TË PUBLIKUARA ME DATË 26.05.2017.

Agjencia me datë 26.05.2017 ka bërë publikimin e FTESËS për aplikim me qëllim të hartimit të Listës Përfundimtare të Punëtorëve për NSH "Teuta Bare" në Mitrovicë dhe NSH KB "Zivko Vasic" në Ranillug-Kamenicë, për arsye se organi përfaqësues i kësaj NSH-je nuk ka qenë bashkëpunues në finalizimin e listës së përkohshme, ashtu siç kërkohet me legjislacionin e aplikueshëm për një periudhë kohore për më shumë se një vit. Në përputhje me këtë publikim, ankuesit kanë pasur të drejtë që t'i parashtrorjnë kërkesat-ankesat e tyre për tu përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve deri më 17.06.2017. Numri i kërkesave-ankesave të parashtruara ndaj Ftesës për aplikim në Agjenci në lidhje me NSH KB "Zivko Vasic" në Ranillug-Kamenicë ishte tetë(8) ankesa, ndërsa për NSH "Teuta Bare" në Mitrovicë është zero(0) ankesa.

Agjencia me datë 30.08.2017 ka pranuar Aktvendimin nr. AC-I-16-0268-A0001, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës(DHPGJSK), të datës 28.08.2017, përmes së cilit theksohet se *"AKP-ja nuk ka të drejtë të publikoj Ftesë për aplikim individual të punëtorëve të NSH-së"*.

Duke u mbështetur në udhëzimin e dhënë nga DHPGJSK përmes Aktvendimit nr. AC-I-16-0268-A0001, të datës 28.08.2017, duke konsideruar se DHPGJSK është organ i cili është i themeluar ekskluzivisht për çështje që lidhen me AKP, mbi arsyet e theksuara Agjencia bën anulimin e "Ftesës për aplikim me qëllim të hartimit të Listës Përfundimtare të Punëtorëve"për NSH "Teuta Bare" në Mitrovicë dhe NSH KB "Zivko Vasic" në Ranillug-Kamenicë, të publikuara me datë 26.05.2017.

Përmes këtij njoftimi, të gjithë parashtruesit e kërkesave-ankesave dhe punëtorët e NSH-ve në fjalë njoftohen lidhur me anulimin e Ftesës për aplikim me qëllim të hartimit të Listës Përfundimtare të Punëtorëve për 20%, për NSH "Teuta Bare" në Mitrovicë dhe NSH KB "Zivko Vasic" në Ranillug-Kamenicë, të publikuara me datë 26.05.2017, përmes mjeteve të informacionit publik në Kosovë, Serbi, dhe Mal të Zi si dhe në faqen zyrtare të Agjencisë në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi.

Agjencia do të publikoj listën e përkohshme të punëtorëve për 20% për NSH në fjalë, në lidhje me këtë parashtruesit e kërkesave-ankesave si dhe punëtorët do të njoftohen me shpalljen e listës së përkohshme të punëtorëve për 20%, përmes mjeteve të shkruara të informimit publik në Kosovë, në Serbi dhe në Mal të Zi si dhe në faqen zyrtare të Agjencisë në përputhje me Rregulloren 2003/13(me ndryshime).